



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:239697
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05404486

C.nr. 18/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të H.J nga Fushë Kosova, rr. ... kundër të paditurës S.S nga Vushtrria, rruga ...të cilën e përfaqëson me autorizim Av. F.B nga Vushtrria, me objekt kontesti Vërtetim pronësie në bazë të trashëgimisë, jashtë seance me datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia me shenjën C.nr.18/17 e datës 17.01.2017 e paditëses H.J nga Fushë Kosova, rruga ... kundër të paditurës S.S nga Vushtrria, rr... me objekt kontesti vërtetim i të drejtës së pronësisë sipas trashëgimisë.

A r s y e t i m

Paditësja H.J nga Fushë Kosova, rruga ... me datë 17.01.2017, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për Vërtetim i së drejtës pronësore në bazë të trashëgimisë, kundër të S.S nga Vushtrria, rruga ...

Në seancën e datës 04.03.2024, paditësja ka deklaruar se qëndron fakti se me padinë e parashtuar me datë 17.01.2017, ka kërkuar nga gjykata që ti njihet e drejta e pronësisë sipas trashëgimisë prej 1/5 në parcelën kadastrale *numri i parcelës* me sipërfaqe prej 274 m katror, ZK Vushtrri, por tani nuk dëshiron të vazhdoj më sipas kësaj padie për vërtetim të pronësisë dhe nuk kërkon trashëgimi-hise në këtë pasuri, por kur e ka parashtuar padinë e ka pas fjalën që ti lejohet të shkoj herë pas here tek shtëpia e ish babait të saj H.S, e cila është e ndërtuar në këtë parcelë, dhe që të mos e pengojnë të qëndroj për një kohë të caktuar, pra nuk ka pretendime të tjera pronësore

sa i përket kësaj parcele. Andaj, ka theksuar se nuk është më e interesuar që ta vazhdoj procedurën në gjykatë sipas kësaj padie për vërtetimin e pronësisë dhe e tërheq padinë.

Marrë parasysh se paditësja e ka tërhequr padinë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr. 18/17, me datë 04.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.